



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:051895

Datë: 08.08.2024

Numri i dokumentit: 06033890

**P.nr.769/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoreshen profesionale Kadishe Ajvazi Demi, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.M...nga Gj..., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-s), sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.302/23 të datës 30.10.2023, të cilën e përfaqëson Prokurori i Shtetit Flamur Ahmeti, pas mbajtjes së seancës fillestare publik, më datën 20.06.2024, shpalli dhe mori këtë,

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri L.M..., i biri i H... dhe nënës F..., e lindur S..., i lindur me datë .., në fshatin T..., ndërsa me vendbanim në Gj..., rruga "...", rruga VIII, nr.67, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar për një vepër penale ndërsa nuk udhëhiqet procedurë penale ndaj tij.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 31.12.2021, në kohë të papërcaktuar, në Gjilan, i pandehuri, me anë të lajthimit, ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, duke shmangë pagesën për shërbime të tilla, në atë mënyrë që, i dëmtuari A.B...ia ka dhënë në shfrytëzim 663 copë mbajtëse të skeleve për ndërtim dhe atë fillimisht për 32 ditë, me çmim 03 cent, pastaj, me datë 18.07.2022, të njëjtit kanë përpiluar një marrëveshje të thjesht mes vete dhe janë marrë vesh që shtyllat t'i mbaj për një vit dhe më së largu deri me datë 15.12.2022, i pandehuri, ka marrë obligim që të bëjë pagesën në tërësi, ose të kthej skelet, mirëpo deri më sot, i pandehuri nuk e ka përmbushur obligimin e tij, me çka të të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar;

-me çka ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 69, 46, 47, 48, 49, 70, 71 dhe 72 të KPRK-s, si dhe nenit 364 të KPP, të akuzuarit I shqipton,

## DËNIM ME KUSHT

**I.** Të akuzuarin L.M..., për veprën penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, i shqiptohet:

**Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

**II.** Pala e dëmtuar A.B..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

**III.** Obligohet i akuzuari që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumë prej 20.00 (njëzetë) euro, në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

**IV.** Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20.00 € (njëzetë euro), në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### **1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 30.10.2023, ka ngritur aktakuzë, me numër të lëndës PP.II.nr.302/2023, kundër të akuzuarit L.M...nga Gj..., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar dhe publik më datë 20.06.2024, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar prokurori i shtetit Flamur Ahmeti, i pandehuri L.M..., i dëmtuari A.B.... Pas leximit të aktakuzës nga prokurorit të shteti, në këtë seancë, i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit.

### **2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe të dëmtuarit ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit L.M..., për kryerjen e veprës penale për të cilat akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehuri L.M...ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s.

### **4. Elementet e veprës penale**

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin L.M...për kryerjen e veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 4

lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtat është dhe penalisht përgjegjës.

**5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 69,70,71 dhe 72 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin L.M...si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është pënduar për veprën penale të kryer, kërkim falja e bërë të dëmtuarit dhe premtimi se do tia kthej shtyllat ose do e kompensojë të dëmtuarin për dëmin e shkaktuar dhe premtimin se në të ardhmën nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti dëmin e shkaktuar të dëmtuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrezikshmërin shoqërore të veprës penale, peshën e veprës penale si dhe përgjegjsinë penale.

**6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar**

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit L.M..., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

**7. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike**

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

**8. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale**

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 450 paragrafi 1 të KPP, ka obliguar të pandehurin ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, paushallin gjyqësor si dhe konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të detyroj të pandehurin të paguaj taksën për viktimat e krimit (Ligji nr.08/L-109), të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**P.nr.769/2023, më datën 20.06.2024**

**Bashkëpunëtoresh profesionale,**  
Kadishe Ajvazi Demi

**Gjyqtari,**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE;** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.